



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

---

Numri i lëndës: 2024:028662 **C. nr. 475/2024**  
Datë: 27.08.2024  
Numri i dokumentit: 06091306

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Atdhe Berisha, me bashkëpunëtorin profesional I.S. në çështjen kontestimore të paditësve: I.K. nga Prizrenit me numër personal ..... dhe F.B. nga Jabllanica me numër personal ..... tani me banim në Prizren, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson avokate B.M.K. nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, Prizren, me objekt kontesti pagesa mbi bazën e përqindjes së inflacionit në pagë, vlera e kontestit 162.12 euro, jashtë shqyrtimit kryesor, më datë 27.08.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**  
Pa shqyrtim kryesor të çështjes

I. APROVOHET në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditësve I.K. dhe F.B. që të gjithë nga Prizreni.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, Prizren, që paditësve në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit, t'ua kompensojë shumën dhe atë:

- Paditëses I.K. Për periudhën kohore 01.10.2022 - 20.11.2022, (për 1 muaj e 20 ditë) në shumën prej 81.06 euro.
- Paditëses F.B. Për periudhën kohore 01.10.2022 - 20.11.2022, (për 1 muaj e 20 ditë) në shumën e prej 81.06 euro.

Në shumën e përgjithshme prej 162.12 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (25.01.2024), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

III. DETYROHET e paditura, që në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësve t'ua paguaj shumën prej 124.00 euro, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

**A r s y e t i m**

Paditësit I.K. dhe F.B. që të dy nga Prizreni, në këtë gjykatë me datë 25.01.2024, përmes të autorizuarit të tyre, kanë ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Prizrenit – Drejtoria

Komunale e Arsimit, Prizren, me të cilën kanë kërkuar nga gjykata që ta detyroj të paditurën për pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit në pagë, duke theksuar se paditësit Icret Kirikul dhe Fatima Bilibani, janë në marrëdhënie pune në SHFMU “Motrat Qiriazhi” në Prizren, dhe bazuar në nenin 35 par.10 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, është paraparë që për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja e inflacionit të futet në pagë. Shuma për kompensimin sipas inflacionit në vend për periudhën kohore për vitin 2022, paditësve secilit i takon shuma në lartësi prej 81.06 euro. Po ashtu ka theksuar se edhe pas kërkesës së vazhdueshme për këto kompensime pranë të paditurës, deri më tani nuk ka marrë përgjigje. Pasi që e paditura nuk e ka përmbushur kërkesën e paditësve vullnetarisht, gjykatës i ka propozuar që të merr aktgjykim dhe ta aprovojë kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore i kanë kërkuar.

E paditura Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, përmes të autorizuarës të saj, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi me datë 04.07.2024, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar. Pretendimet e paditësve se i takon kompensimi i inflacionit është në kundërshtim me nenin 2 paragrafi 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, sepse në këtë dispozitë shkruan qartë se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit-SBASHK-ut. Paditësi ushtron padi në gjykatë për realizimin e të drejtave të tyre pa përfunduar procedura administrative, sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren. Padia është në kundërshtim të plotë me nenin 56 të Ligjit të Punës, sepse me këtë dispozitë parashihet decidivisht se çka përfshinë paga shtesë. Andaj çështja e pagës shtesë për shkak të inflacionit siç pretendojnë paditësve nuk lejohet me ligjin e punës, i cili ligj në këtë rast është ligj i veçantë dhe e rregullon çështjen e pagës shtesë dhe rrjedhimisht ligji i veçantë në çdo çështje ka epërsi kundrejt çdo ligji apo akti nënligjor. Pretendimet e paditësve se i takon beneficioni nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, janë në kundërshtim me nenin 90 paragrafët 1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës të R. Kosovës Nr.03/L-212, sepse sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet në mes të organizatës së punëdhënësve dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e kësaj kontrate. Ka theksuar se në bazë të njoftimit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit nr.01B/ të datës 21.11.2022, për shkëputjen e Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 22.01.2021 padia dhe kërkesëpadia e paditësve është e pa bazuar. Në fund gjykatës i ka propozuar që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj në tërësi si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 152 të LPK, gjeti se kërkesëpadia e paditësve është e themeltë, andaj pa caktuar seancë gjyqësore, vendosi lidhur me kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqësve të paraqitura me padi dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nga vërtetimi për paditësen Icret Kirikul me numër të protokollit 519/23, e datës 13.12.2023, e lëshuar nga drejtori i shkollës, në versionin e fotokopjuar, vërtetohet fakti se

paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, në SHFMU ‘‘Motrat Qiriazhi’’ në Prizren, si mësimdhënëse që nga viti 1992 dhe vazhdon të jetë në marrëdhënie kontraktuale me SHFMU ‘‘Motrat Qiriazhi’’ në Prizren, deri më tani dhe atë si mësimdhënëse. Bazuar në Listat e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës vërtetohet lartësia e pagës bazë të paditësit e që është shuma prej 421. Ndërsa për paditësen tjetër F.B. nga vërtetimi me numër të protokollit 519/23, e datës 13.12.2023, e lëshuar nga drejtori i shkollës, në versionin e fotokopjuar, vërtetohet fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, në SHFMU ‘‘Motrat Qiriazhi’’ në Prizren, si mësimdhënëse që nga viti 2000 dhe vazhdon të jetë në marrëdhënie kontraktuale me SHFMU ‘‘Motrat Qiriazhi’’ në Prizren, deri më tani dhe atë si mësimdhënëse. Bazuar në Listat e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës vërtetohet lartësia e pagës bazë të paditësit e që është shuma prej 421.

Po ashtu gjykata bazuar në Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin 2022 ka qenë 11.6%. Gjykata provave të lartcekura iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se *‘‘Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të’’*.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021, ku në nenin 35 par.10 parashihet se *‘‘Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë’’*, si dhe duke u bazuar edhe në mendimin juridik të gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 date 09.10.2023 ku në pikën II parashihet që *‘‘Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve’’* ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditësit i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë sipas përlllogaritjes së bërë në këtë mënyrë:

Për paditësen I.K.

- Për periudhën 01.10.2022 deri më datë 20.11.2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit për vitin 2022 ka qenë 11.6%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësit në vitin 2022 ka qenë 421 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 81.06 euro ( $421 \times 11.6\% = 48.83$  \* 1 muaj e 20 ditë = 81.06).

Për paditësen F.B.

- Për periudhën 01.10.2022 deri më datë 20.11.2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit për vitin 2022 ka qenë 11.6%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësit në vitin 2022 ka qenë 421 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 81.06 euro ( $421 \times 11.6\% = 48.83 * 1 \text{ muaj e } 20 \text{ ditë} = 81.06$ ).

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 152 të LPK, gjeti se kërkesëpadia e paditëses është e themeltë, andaj pa caktuar seancë gjyqësore, vendosi lidhur me kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (25.01.2024), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigj në padi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Gjykata ka vlerësuar edhe provat tjera materiale të cilat gjinden në shkresat e lëndës, por ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453.2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 104.00 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 20.00 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 124.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me nenin 143 dhe 152 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN  
C.nr.475/2024, datë 27.08.2024

G j y q t a r i  
Atdhe Berisha

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.